



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMI
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 2023/202

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, si dhe nenin 50 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Ligji nr. 05/L-031, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mbikëqyrja e Investimeve Kapitale në Komunën e Rahovecit", me numër të prokurimit 623-23-363-2-2-1, me datën 17.07.2023, mori këtë:

KONKLUZION

Ndryshohet/ plotësohet Vendimi me nr. të protokollit 2023/202, i datës 14.07.2023, që në faqen e parë të këtij vendimi konkretisht tek pika 1 e dispozitivit si në vijim :

1. Aprovohet pjesërisht, si e bazuar ankesa e OE AL Engineering SH.P.K. me nr. 2023/0202, e datës 12/04/2023, kurse vendimi i AK Komuna Rahovec lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mbikëqyrja e Investimeve Kapitale në Komunën e Rahovecit" me numër të prokurimit 623-23-363-2-2-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

Ndryshohet/plotësohet me fjalinë si më poshtë:

1. Aprovohet pjesërisht, si e bazuar ankesa e OE AL Engineering SH.P.K. me nr. 2023/0202, e datës 12/04/2023, kurse aktiviteti i prokurimit "Mbikëqyrja e Investimeve Kapitale në Komunën e Rahovecit" me numër të prokurimit 623-23-363-2-2-1 inicuar nga Komuna e Rahovecit, anulohet në tërësi.

A r s y e t i m

Me rastin e përpilimit të Vendimit PSH. nr. 2023/202, i datës 14.07.2023, në faqen e parë tek pika 1 e dispozitivit, është lëshuar një gabim teknik dhe me këtë rast edhe bëhen plotësimet e duhura sipas këtij Konkluzioni.

Kryetari i panelit shqyrtues pasi që është njoftuar se në vendimin e lartcekur ka lëshime teknike, në pajtim me nenin 50 të Ligjit për Procedurë Administrative Ligji Nr. 05/L -031, me anë të këtij konkluzioni bën korrigjimin e lëshimit duke vendosur si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

Kryetari i panelit shqyrtues konform nenit 50 të Ligji Nr. 05/L -031, si dhe duke u bazuar në sqarimet e dhëna si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës komerciale- në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Vedat POTERQOI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna Rahovec

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.